



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 15

Datë: 28. 04. 2023. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Certifikimi i Rezultateve, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq**
- 3. Raport i Këshillave të KQZ-së**

-Këshilli për Operacione Zgjedhore

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të KQZ-së për Kuvendin e Republikës së Kosovës – 2022

- Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës së bazës së shënimeve të departamentit të pensioneve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë për ndryshim/ plotësimin e Planit të Prokurimit të KQZ për vitin 2023

5. Të ndryshme !

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Kryetari Radoniqi, pasi që hapi mbledhjen, paraqiti agjendën. Në ndërkohë, anëtarët e KQZ me vota unanime, miratuan agjendën e takimit.

Në vazhdim, kryetari Radoniqi, propozoi certifikimin e zgjedhjeve pasi që nga PZAP është pranuar informacioni se nuk ka pasur asnjë ankesë që, e ankimon procesin. Ai, konstatoi se janë plotësuar kushtet që KQZ, ti certifikoj rezultatet e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq.

Ti certifikojmë rezultatet, një nga një. Zgjedhjet për Kryetar Komune:

Komuna e Leposaviqit

1. Lulzim Etemi nga Lëvizja “Vetëvendosje!” ka marrë 73.5 % të votave.
2. Albulena Behluli – Etemi nga PDK ka marrë 25% të votave
3. Aleksandër Jabllanoviq nga subjekti “Partia Kosovski Serba” ka marrë 1.5%.

Kryetar komune në Leposaviq, me 73.5 % të votave të fituara, është zgjedhur Lulzim Etemi nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!”.

Kush është për...?

Me 10 vota për, dhe 1 abstenim, certifikohet rezultati për komunën e Leposaviqit.

Komuna e Zubinpotokut

1. Izmir Zeqiri nga Partia Demokratike e Kosovës, ka marrë 55.2 % të votave.

2. Flatron Hasani nga Lëvizja “Vetëvendosje!” ka marrë 47.7 % të votave.

Kryetar komune në Zubinpotok me 55.2 % të votave të fituara, është zgjedhur Izmir Zeqiri nga Partia Demokratike e Kosovës.

Kush është për...?

Me 10 vota për, dhe 1 abstenim, certifikohet rezultati për komunën e Zubinpotokut.

Komuna e Zveqanit

1. Ilir Peci nga Partia Demokratike e Kosovës, ka marrë 59 % të votave.

2. Fetah Peci nga Lëvizja “Vetëvendosje!” ka marrë 37.3 % të votave.

3. Sllagjana Pantoviq, ka marrë 3.6% të votave.

Kryetar komune në Zveqan, me 59% të votave të fituara, është zgjedhur Ilir Peci nga Partia Demokratike e Kosovës.

Kush është për...?

Me 10 vota për, dhe 1 abstenim, certifikohet rezultati për komunën e Zveqanit.

Komuna e Mitrovicës së Veriut

1. Erden Atiq nga Ilir Peci nga Lëvizja “Vetëvendosje!” ka marrë 66.9 % të votave.

2. Taulant Kelmendi nga Partia Demokratike e Kosovës, ka marrë 23.4 % të votave.

3. Betim Osmani nga iniciativa qytetare “Mitrovica”, ka marrë 9.7% të votave.

Kryetar komune në Mitrovicën e Veriut, me 66.9% të votave të fituara, është zgjedhur Erden Atiq nga Lëvizja “Vetëvendosje!”

Kush është për...?

Me 10 vota për, dhe 1 abstenim, certifikohet rezultati për komunën e Mitrovicës së Veriut.

Rezultatet e votimit për asambljetë komunale:

Komuna e Leposaviqit

1. Lëvizja “Vetëvendosje!” ka fituar 76.1%, apo me 15 ulëse të fituara.
2. Partia Demokratike e Kosovës me 19.2%, me 2 ulëse të fituara.
3. Subjekti “Partia Kosovski Serba” me 4.6% me dy ulëse të fituara.

Komuna e Zubinpotokut

1. Lëvizja “Vetëvendosje!” ka fituar 76.1%, apo me 15 ulëse të fituara.
2. Partia Demokratike e Kosovës me 19.2%, me 2 ulëse të fituara.
3. Subjekti “Partia Kosovski Serba” me 4.6% me dy ulëse të fituara.

Komuna e Zveqanit

1. Lëvizja “Vetëvendosje!” ka fituar 76.1%, apo me 15 ulëse të fituara.
2. Partia Demokratike e Kosovës me 19.2%, me 2 ulëse të fituara.
3. Subjekti “Partia Kosovski Serba” me 4.6% me dy ulëse të fituara.

Komuna e Mitrovicës së Veriut

1. Lëvizja “Vetëvendosje!” ka fituar 76.1%, apo me 15 ulëse të fituara.
2. Partia Demokratike e Kosovës me 19.2%, me 2 ulëse të fituara.
3. Subjekti “Partia Kosovski Serba” me 4.6% me dy ulëse të fituara.

Sami Hamiti, tha se e kemi diskutue në Këshillin për Cështje Ligjore çështjen e fituesve për asamble në këtë komunë, dhe kemi dilema dhe na duhet një interpretim për kandidatët. Është mirë që ne ta certifikojmë përqindjen e kandidatëve, dhe renditja le të certifikohet por na duhet një interpretim. Ama, nuk kemi pajtim rreth numrit të kandidatëve... Rënditjen mund ta bëjmë, por vendet nuk mund ti përcaktojmë, pa një interpretim...Ka dilema, ka zbrastësira...

Alban Krasniqi, tha se neni 8 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale te shpërndarja e vendeve të kuvendit komunal, nëse i referohemi pikës a, b, c, de që përshkruan mënyrën si bëhet shpërndarja e vendeve në kuvendin komunal, mund të vërehet shumë lehtë që mandatet fitohen sipas koeficientit që e fitojnë partitë sipas renditjes së formulës si është dhe, mendoj kjo sqaron çdo gjë. Për pjesët tjera, mendoj që ligji është i qartë, për deri sa vota për subjektin është ajo që është kryesorja, kjo për kandidatin është sekondare, dhe ne nuk kemi të drejtë me i nda mandatet ndryshe veçse, si e përcakton ky nen i këtij ligji. Koeficienti kur llogaritet, llogaritet për votat që i ka marrë subjekti, dhe jo për votat që i ka marrë kandidati... Duhet të kemi kujdes të mos bëjmë shkelje ligjore, duke mos i nda mandatet, përndryshe pjesa tjetër është e qartë sepse e kuptojmë se cili është edhe qëllimi i votës preferenciale...

Ilir Gashi: Është e vërtetë se atë që se thotë ligji 'ex officio', interpretohet ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe mbi këtë bazë ndahen dhe shpërndahen ulëset! Nëse, kryetari i lexon emrat e secilit asamblistë që ka fitue vota, ngase ne i certifikojmë veç e veç: së pari subjektin politik me përqindjet e fituara, ulëset e ndara, pastaj listat... Do të thotë, ne si KQZ duhet ti certifikojmë subjektet dhe kandidatët të cilët, kanë marrë vota dhe numri i të cilëve dihet është dhe, ecim tutje me këtë certifikim...S'mund ta votojmë një person që ka zero vota, dhe ai s'ka legjitimitet...Subjekti votohet, veç por edhe kandidatët veç e veç votohen dhe certifikohen...Edhe në këshill kemi debatuar gjatë, po s'kemi mundur me gjet kompromis, por unë s'mund ta votoj një kandidatë që ka zero votë...

Sami Hamiti: Po i referohem Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 106 që thotë: "Publikon rezultatet përfundimtare në formë tabelore duke përfshirë dhe numërimin e votave të fituara për secilin kandidat individual". I kthehem nenit 8.2, e që është ka zbrastësirë por, që prapë ju referohet kandidatëve – votës, pra jo zeros...! Këtu s'ka politikë: ligji në të dy rastet, i referohet votës! Nuk është listë e mbyllur se po t'ishite, përfundon debati por, është listë e hapur...

Prandaj, unë nuk votoj një kandidat që nuk ka votë...

Alban Krasniqi: Ata që e kuptojnë sistemin e hapur dhe të mbyllur e kuptojnë pak a shumë...! Kjo nuk bahet me matë ose jo legjitimitetin e dikujt, se a ka të drejtë me u zgjedhë apo jo, se a merr zero votë apo një votë, por që është një garë brenda një subjekti. Për KQZ në këtë moment, më i rëndësishëm është neni 8 i shpërndarjes së vendeve në kuvendin komunal, nenet tjera nuk përbëjnë, aq më pak nenet e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme sepse e kemi të qartë se nenet e ligjit për zgjedhjet lokale – ju referohen vetëm zgjedhjeve lokale!

Në rastin kur nuk rregullohet kjo pjesë, neni e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme vlejnë edhe për zgjedhjet lokale, por nuk mundet me u mbivendosë asnjë të asnjë legjislacioni tjetër, përveç nga interpretimi kushtetues: neni 8 që neve na detyron që shpërndarjen e mandateve (po flas për shpërndarje të mandateve dhe jo për individ), dhe ne shpërndarjen e mandateve përfundimtare për certifikim, duhet të jetë në përputhje me këtë nen...

Kjo tregohet qartë me nenin 8: për aq sa ka kandidatë një subjekt, për aq shkon ndarja e mandateve sipas përpjesëtimit që e dimë ne që merremi me këto çështje...!

Sami Hamiti: Kjo, është listë e hapur proporcionale. PDK i ka qitë dy kandidatë, e i ka marrë 30%... Më duket se, është mirë që ekzistojnë edhe shkallët tjera...

Ilir Gashi: Formulën dhe mandatet e fituara nuk është duke i kontestuar askush! Problemi është ky: ne mund të shkojmë në dy procese: miratimin e mandateve të secilit subjekt politik, dhe certifikimin.

Arianit Elshani: Pra, askush nuk e konteston përqindjen e fituara të votës, sepse votuesi ka vendosur, pra edhe mandatet e fituara...! Sa i përket votave të fituara, çdo gjë është në rregull. Por, numri i votave të kandidatëve për asamble, duhet të sqarohet, madje edhe për opinionin në mënyrë që, të dihet se cilët janë kandidatët sepse, duhet të nominohet asambleja...Pra, ne vet si KQZ duhet ta përkufizojmë problemin...

Ne si KQZ, kemi për mandat që t'a certifikojmë rezultatin, përqindjen e votave të fituara të subjektit por, edhe numrin e mandateve të fituara, kurse çështjen e përcaktimit të kandidatëve për asamble, se kush është i zgjedhur dhe kush nuk është i zgjedhur, realisht, ne i certifikojmë, ne u tregojmë edhe institucioneve të tjera, në këtë rast kuvendit komunal, duke i treguar se: "Ky është asamblisti juaj që duhet me u zëvendësua, që i plotëson kriteret ligjore, sipas interpretimit të gjykatës kushtetuese edhe të çështjes së gjinisë në këtë rast, pra ky është personi për të qenë asamblistët...". Si KQZ, nuk mund të lëmë amulli...

Sami Kurteshi: Ne diskutoam, diskutoam por, unë kam një problem, dhe problemi im është teorik, e kjo është që ne nuk e kemi trajtuar si KQZ, e kjo nuk është e përcaktuar edhe me ligj shprehimisht...Pra, kur jemi brenda procesit nuk kemi të drejtë ta ndërrojmë praktikën, dhe të marrim vendime si kemi diskutua, si kemi vendos...KQZ, nuk e ka shtjerrë debatin, edhe pse ka të drejtë... Një diskutim të këfillë nuk e kemi bërë, bie fjala subjekti ka një bartës të listës, dhe për shembull votat i kanë shkue bartësit të listës, dhe kandidatet tjerë nuk kanë vota, kanë zero votë, tash si e ndërtojmë – shpërndajmë votën...

Nuk mund të diskutojmë deri në fund, brenda procesit! Unë jam të ecim sipas ligjit: dikush pastaj, mund të ankimojë... Unë, jam për ndarjen e mandatit, tjetri le të ankohet...

Ilir Gashi: Ne këtu, sa u përket kandidatëve, gjithmonë kemi pas një dakordim, ne asnjë herë s’kemi certifikue listë pa i pas emrat e atyre që e kanë fitue mandatin...Kemi ba votim total, po asnjëherë pa i pasur emrat... Votohet formula, dhe votohen kandidatët që kanë marrë mandatin...

Arianit Elshani: Ne, e kemi marrë rekomandimin, por unë s’po e kuptoj se si mundemi me votue kandidatin me zero votë, qysh bahet ndarja e mandateve të kandidatëve me zero votë...? Pra si bëhet, sepse edhe si rekomandim nuk kemi se si të bëhet...

Kreshnik Radoniqi: Unë sa po kuptoj, çështjen, e kemi vetëm në komunën e Leposaviqit...!

Mirë, kontestuese janë vetëm dy mandate. Listën që e kemi në kompjuter i ka 16 persona, e këtu, në tërësi i kam 19... Pse nuk përputhet...? Mirë, 3 janë kontestuese... A i votojmë këta, për 3 tjerë nuk është e qartë, nuk dimë si me veprua... Kemi disa interpretime, dhe nuk kemi konsensus, na nevojitet një mendim tjetër, ose mundet mu parashture ankesë në PZAP dhe e marrim përgjigjen prej gjyqtareve të PZAP-së. Mendoj që kjo është më e drejtë, se mundemi me marrë veprim të gabuar, ose me ja shkelë dikujt të drejtën ! A po pajtohemi ?

Sami Kurteshi: Kryesues, në të gjitha rastet kur një çështje, se unë nuk jam gjykatës por, kur një çështje nuk është e specifikuar deri në fund, “mos specifikimi” sipas ligjit, shkon te e drejta e personit...! Unë mendoj se e drejta a me i certifikua të gjithë, dhe nëse dikush bënë ankesë ne mund ti themi se “qe, janë tre kandidatë më zero vota”, dhe këta s’mund të certifikohen – një ankesë në PZAP...Nëse ne nuk i certifikojmë..., ne e interpretojmë ligjin në dëm të tyre... Kur ligji nuk është i qartë, duhet të interpretohet në favor të tyre, jo në dëm të tyre !

Sami Hamiti: Kush ja ka shkel, kur s'ja ka dhanë vetës votën...! Ne e kemi një problem kur 10% të votave, shkojnë të pavlefshme se, votohet kandidati, s'votohet...! Praktika tregon: votohet kandidati – s'votohet subjekti, s'ndodh me tu votue ty subjekti e, mos me u votue kandidati... të rralla janë, 100 në 1...

Alban Krasniqi: Çfarëdo veprimi që marrim, duhet me i parapri së pari nenit 8, në vendim të KQZ duhet mu reflektua ky nen, për mua kjo është e qartë... (z. Krasniqi, e rekapitului edhe njëherë këtë nen, dhe faktin si bëhet shpërndarja e mandateve...) Nëse lexohet ky nen, shpjegohet si bëhet shpërndarja, legjitimiteti ekziston... Ne jemi të thirrur ta votojmë nenin 8, nëse jo, unë s'mund ta votojë...

Sami Hamiti: E lexova edhe unë nenin 8, nuk është ashtu...

Ilir Gashi: Shkurt: neni 8, pika 2: "Të gjitha votat e fituara nga kandidatët..."

Alban Krasniqi: Ti, vendos sipas nenit 8.1... (ai, e lexoi këtë nen...)

Ilir Gashi, po ashtu e lexoi nenin: 8.2...

Kreshnik Radoniqi: Ju lutem, e lexojmë ligjin por ligji nuk e ka parapa gjendjen e krijuar në veri, bojkotimin, mos daljen...E kemi një situatë tjetër...kemi dilema të gjithë...ne, asnjëri nuk detyrohet me votue...shkojmë me ata që kanë vota...votojmë...për tre tjerët, na tregojnë institucionet tjera...Janë 16 persona që mund të certifikohen, 3 të tjerë shohim si na thonë institucionet tjera...

Unë, po i hedh në votim vetëm personat që mundemi me i votue...

Sami Kurteshi: Ky diskutim mbaroi, por unë jam për dy variante të votimit: me e votue "pozicionin" sa mandate i ka fitue, dhe tjetrin, me votue "a, votohen ata që s'kan votue" por, nuk jam për vetëm një variant...

Alban Krasniqi: Numrin e mandateve e kemi për obligim me e votue...

Kreshnik Radoniqi: Atë, nuk po e konteston askush...

Arianit Elshani: Mundet me pas rrethana kur ti kandidatë ma shumë se sa që ke përqindje për me tu shpërnda koeficienti, këto i parasheh ligji...! Në momentin që ti nuk ki kandidat në kuadër të listës tënde kandiduese, ai koeficient nuk llogaritet fare dhe shkon te subjekti i radhës...

Prandaj, unë jam dakord me rezultatin dhe përqindjen, po mandatet...! Jam dakord që të hedhen dy variante, dy vendime, në mënyrë që ti mundësohet dikujt me ba ankesë lidhur me çështjen e ndarjes së mandateve...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, varianti i parë:

- 1.Lëvizja “Vetëvendosje!” me 83 vota, ose 76.1%
2. Partia Demokratike e Kosovës me 21 vota, ose me 19.2%
3. Partia “Kosovki Serba” me 5 vota, ose 6.6 %

Kush është për këtë rezultat ? Certifikohen me 10 vota për, dhe 1 apstenim.

Sa u përket mandateve:

- 1.Lëvizja “Vetëvendosje!” ka 12 persona të votuar...
2. Partia Demokratike e Kosovës ka 2 persona të votuar...
3. Partia “Kosovki Serba” i ka 2 persona të votuar...

Alban Krasniqi, nuk u pajtua me formën se, çka po votohet...lista, mandatet, apo çka...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për këtë listën që e kam para vetës me 16 kandidatë ...? Certifikohen me 6 vota për. Kush është kundër ? 1, 2, 3... Nuk kalon... Nuk votohet...

Komuna e Zveqanit

- 1.Partia Demokratike e Kosovës, ka fituar 98 vota, ose 60.1%: ka 11 ulëse të fituara. (këtu në listë 25 kandidatë...ok...)
2. Lëvizja “Vetëvendosje!” ka fituar 65 vota, ose 39.9%: ka 8 ulëse të fituara.

Kush është për këtë rezultat ? Me 10 vota për, 1 abstemi certifikohet rezultati...

6. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të KQZ-së për Kuvendin e Republikës së Kosovës – 2022

Arianit Elshani, tha se KOZ-i ka shqyrtuar raportin vjetor të KQZ-së që i përcillet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ky raport, pasqyron punën e KQZ për vitin 2022, pra aktivitetet dhe punën e institucionit tonë!

Sekretariati, në prill e ka dërguar një draf – raport. Ndërkohë nga z. Kurteshi dhe anëtarët e tjerë janë dhënë komentet dhe vërejtjet. Këtu, janë përmbledhë të gjitha aktivitetet, përfshirë zgjedhjet e jashtëzakonshme të dhjetorit, rregullat zgjedhore, rekomandimet tona, 48 rekomandime tonat për reformën zgjedhore, çështjet që lidhen me softverin e QNR dhe proceset e tjera të aktiviteteve tona...

Natyrisht, në raport përfshihen edhe sfidat tona, mungesën e hapësirave të KQZ-së, mos aprovimi i buxhetit në investimet kapitale etj. Janë të përfshira në raport edhe rekomandimet për kuvendin dhe qeverinë etj.

Në debat lidhur me këtë pikë, **Sami Kurteshi** tha se, e kam lexuar raportin, kam bërë disa intervenime, kryesisht teknike, por edhe në aspektin përmbajtjesorë dhe gjuhësorë. Ky, është një nga raportet më të mira, po them për mua...! Unë, kam bërë tri rekomandime të shtuara, mendoj që kanë vend në raport, mund ti diskutojmë... Janë këto rekomandime: alokimi i kodit të veçantë buxhetor për zyrën e partive, ky është detyrim ligjorë. Lejimi i krijimit të një pozite të për një auditor të brendshëm, sigurimi i mjeteve për modernizimin e QNR-së.

Sami Hamiti, tha se në KOZ e kemi debatuar raportin. I pash edhe rekomandimet e z. Kurteshi, dhe pajtohem plotësisht, sepse janë edhe obligime ligjore...

Čemailj Kurtiši, tha se me kujdes dhe vëmendje e ka lexuar raportin. Mund të konstatoj se raporti është punuar jashtëzakonisht mirë, dhe personalisht jam i kënaqur me punën tonë në vitin e kaluar, dhe kjo është e pasqyruar si duhet në raport, tha z. Kurtiši. Më tej, ai tha se i përkrahë kërkesat, rekomandimet por, pavarësisht ndonjë gabimi kryesisht teknik, raporti përnjëmend është i punuar mirë, me përkushtim dhe e përkrahi plotësisht...

Ilir Gashi, tha po ashtu se e mbështetet raportin, bashkë me rekomandimet. Mirëpo, ai u ndal te çështja e “kodit” rreth zyrës, dhe e konsideroi si gabim punën e këtij kodi, veçmas ministria sepse kërkesa jonë nuk është përkrahur... Do të duhej me qenë më direkt si KQZ, pra që Kuvendi ta iniciojë këtë çështje...

Alban Krasniqi, tha se nuk po zgjatem: e kemi shqyrtuar, kemi dhënë edhe vërejtjet. Por, rreth kodit, mendoj që kjo ka të bëjë me një procedurë administrative, dhe në bazë të përgjigjes administrative që marrim, ne do të ndërmarrim hapat tonë...

Sami Hamiti, tha se ligji për financa publike e kanë ndryshua me një ligj, nuk kanë mundur me ba, ka ndërhyrje, e problemi është që ligji ka kaluar pa u trajtuar mirë... Duhet me rishikua ligjin, po lejon dy kode buxhetore, dy zyrtarë që unë nuk besoj se kanë me lejue...

Në fund të debatit, kryetari Radoniqi kërkoi votimin e raportit. Me vota unanime, anëtarët e KQZ-së, e votuan Raportin Vjetor të KQZ-së për Kuvendin e Republikës së Kosovës – 2022.

Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës së bazës së shënimeve të departamentit të pensioneve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Aranit Elshani, tha se KOZ e ka shqyrtuar analizën e bazës së shënimeve të departamentit të pensioneve, dhe në të kaluarën kemi marrë veprime, kemi marrë ekstraktin e regjistrin civil për ti pastruar listat, dhe jo vetëm ne jemi ballafaquar me identifikimin e personave të cilët kanë vdekur, ose janë hequr nga lista e departamentit të pensioneve pas moshës 65 vjeçare. Në bashkëpunim edhe me KKZ-të dhe departamentin e pensioneve, gjatë vitit 2022 – 21, në këtë aspekt, nga raporti del se 35 092 persona janë larguar nga lista e përfituesve të pensioneve për shkak të vdekjes. Duke i krahasuar këto të dhëna në raport me ekstraktin civil të marrë nga ARC, del se “2883 persona” realisht figurojnë në regjistrin e ARC.

Janë edhe në formë tabelare nga janë, cila moshë...etj. Në këtë aspekt, ne duhet ti verifikojmë me KKZ-të se këta persona, a janë të gjallë apo të vdekur...

Lidhur me këtë raport, diskutuan: **Sami Kurteshi**, i cili tha se kjo punë është ligjore dhe profesionale dhe ne, duhet ta vazhdojmë pastrimin e listës. Nuk do të jetë një listë perfekte, por ne po bëjmë vërtetë një punë jashtëzakonisht të mirë... Por, duhet të vazhdojmë, duhet ti heqim nga lista edhe

ata persona që heqin dorë nga shtetësia, pra ne jemi duke arritur në një listë votuese ku s' do ketë dyshime...

Sami Hamiti, tha se e përkrah këtë raport, dhe ne po bëjmë punë të mirë, por ARC dhe zyrat nëpër komuna janë ata që i heqin personat nga lista. KQZ nuk është ajo që mund ta pastroj listën, ky është një raport i mirë, padyshim...

Gordana Llabani, tha se e përkrah këtë punë të mirë që po bëhet, por ajo shtroi dilemat se si të bëhet kjo në komunat veriore, si të bëhet atje kur s'ka KKZ, kur s'ka zëvendës...Si ta dimë, kush ta shoh se personat e vdekur mund të hiqen nga lista...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me vota unanime, anëtarët e KQZ-së, e votuan analizën e bazës së shënimeve të departamentit të pensioneve.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë për ndryshim/ plotësimin e Planit të Prokurimit të KQZ për vitin 2023:

Burim Ahmetaj, fillimisht tha se KQZ në muajin janar të këtij viti ka miratuar planin vjetor të prokurimit 2023. Në ndërkohë, ka ardhur nga zyra një kërkesë që të zhvillohen procedurat e prokurimit lidhur me auditimin e raportit financiar dhe deklarimin financiarë të fushatave të subjekteve politike.

Në bazë të buxhetit që kemi, lidhur me këtë aktivitet buxheti është i siguar por ajo që nevojitet në këtë kohë është që të plotësohet plani i prokurimit për këtë vit 2023 edhe me këtë aktivitet, në mënyrë që të fillohet me procedurat e nevojshme...

Në këtë pikë, diskutuan: **Sami Hamiti** i cili pyeti se kur do të fillohet, dhe ai tha se duhet të kihet kujdes, se është problemi specifik, mos e kufizoni afatin e shkurtër sepse, janë vitet e kaluara dhe, kjo punë duhet me qenë tejet profesionale...

Në fund me vota unanime, u miratua kërkesa për ndryshim/ plotësim të Planit të Prokurimit të KQZ për vitin 2023.

8. Të ndryshme !

Kryetari **Radoniqi**, tha se gjatë javës që vjen mund të mbahet një takim i Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë, kurse **Arianit Elshani** tha se është mirë që të shikohet çështja e rregulloreve të brendshme të Zyrës, që na ka mbetur në gjysmë, të caktohet data e takimit....

Pastaj, edhe çështja e strategjisë së KQZ-së e cila, edhe kjo ka mbetur pezull... Na dërgoni një datë, caktojani që të takohemi javën që vjen...Po ashtu, edhe rregulloret e brendshme: kur do të trajtohen, përgatiteni një draft – agjendë...